



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 2519	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1	
Data / Datum / Date: 02/10/2024 Pejë / Peë		

Senati

Ref. Nr.

Pejë, 02.10.2024

Në bazë të nenit 42, 45 dhe 48 të Statutit të UHZ-së, dhe pas shqyrtimit të kërkesës nr. 2505 dt. 01.10.2024, Senati i UHZ në mbledhjen e mbajtur me dt. 01.10.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Kandidatët e nivelit bachelor që kanë aplikuar në programin Menaxhim Biznesi në gjuhën shqipe për vitin akademik 2024/25 dhe që e kanë kaluar pragun, për shkak të kuotës së limituar nuk mund të pranohen. Meqenëse në të njëjtin program në gjuhën boshnjake ka vende të lira dhe në përputhje me kërkesat e kandidatëve, ju mundësohet bartja e tyre në këtë program.
- II. Ky vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi



Vendimi t'i dërgohet: Menaxhmentit të UHZ-së, Dekanëve të njësive akademike, Sekretarëve të njësive akademike, Drejtorit për çështje studentore, Zyrtarëve për çështje studentore, Zyrës së IT, Arkivit të UHZ-së.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. <u>2946</u>	Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>1</u>	
Data / Datum / Date: <u>06.11.2024</u> Pejë, Peë		

Senati

Pejë, dt. 06.11.2024

Në bazë të nenit 42, 45, 47, 48 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, pas shqyrtimit të kërkesave të njësive akademike për regjistrimin e studentëve të nivelit master për vitin akademik 2024/25 gjegjësisht zëvendësimin e kuotave të rezervuara, Senati i UHZ-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 05.11.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M


- I. Për zëvendësimin e kuotave të rezervuara në njësitë akademike për nivelin master për vitin akademik 2024/25 me kandidatë të cilët janë në radhë dhe plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi t'i dërgohet:

- Prorektorëve të UHZ-së;
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Dekanëve të Njësive Akademike;
- Drejtorit për çështje studentore;
- Sekretarëve të Njësive Akademike;
- Zyrës së IT;
- Arkivit të UHZ – së.

Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi

hën





UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJE
REKTORATI		
Nr. / Br. / No.	2658	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Data:	15.10.2024	Pejë / Peë

Senati

Ref. Nr.

Pejë, 15.10.2024

Në bazë të nenit 42, 48 dhe 68 të Statutit të UHZ-së, dhe propozimit nr. 2562 dt. 03.10.2024 të Këshillit të Fakultetit të Biznesit, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me dt.14.10.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Prof. Asoc. Dr. Vlora Berisha zgjedhet Prodekane për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë në Fakultetin e Biznesit në Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.
- II. Mandati i të zgjedhurës fillon më dt. 15.10.2024 dhe përfundon më dt. 30.09.2025
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi t'i dërgohet:

- Të lartpërmendurit;
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Njësisë akademike - F. Biznesit
- Zyrës së financave
- Zyrës së IT;
- Arkivit të UHZ-së.

Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. i Esh. / No.	2659	Nr. i fac / Dr. str / No. eg 1
Data / Datum / Date: 15.10.2024		Pejë / Poë

Senati

Ref. Nr.

Pejë, 15.10.2024

Në bazë të nenit 42, 48 dhe 68 të Statutit të UHZ-së, dhe propozimit nr. 2562 dt. 03.10.2024 të Këshillit të Fakultetit të Biznesit, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me dt. 14.10.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Prof. Asoc. Dr. Fisnik Morina zgjedhet Prodekan për çështje akademike dhe mësimore në Fakultetin e Biznesit në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.
- II. Mandati i të zgjedhurit fillon më dt. 15.10.2024 dhe përfundon më dt. 30.09.2025
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi t'i dërgohet:

- Të lartpërmendurit;
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Njesisë akademike - F. Biznesit
- Zyrës së financave
- Zyrës së IT;
- Arkivit të UHZ-së.

Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. <u>2656</u>	Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>1</u>	
Data / Datum / Date: <u>15.10.2024</u> Pejë / Poë		

Senati

Ref. Nr.

Pejë, 15.10.2024

Në bazë të nenit 42, 45 dhe 48 të Statutit të UHZ-së, nenin 53 të Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Senati i UHZ në mbledhjen e mbajtur me dt. 14.10.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Shfuqizohet pika III e Vendimit nr. 750 dt. 05.04.2022, lidhur me pozitën kryesuese e komisionit të ankesave dhe parashtresave në kuadër të Senatit të UHZ-së, Prof.Asoc.Dr. Sabiha Shala.
- II. Kryesuese e komisionit për ankesa dhe parashtresa në kuadër të Senatit të UHZ-së emërohet Prof.Dr. Mimoza Hyseni Spahiu.
- III. Mandati i Kryesueses është deri më dt. 30.09.2025.
- IV. Pikat tjera të vendimit bazik me nr. 3250 dt. 03.12.2021 mbesin të pandryshuara.
- V. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit bazik me nr. 3250 dt. 03.12.2021 për themelimin e Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa i Senatit të UHZ.
- VI. Ky vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

Arsyetim

Përmes Vendimit nr. 750 datë 05.04.2022, Prof. Asoc. Dr. Sabiha Shala është emëruar kryesuese e komisionit të ankesave dhe parashtresave në kuadër të Senatit të UHZ-së.

Ky vendim ndryshohet dhe plotësohet pasi që Prof.Dr. Sabiha Shala sipas vendimit nr. 2460 dt. 27.09.2024 të Këshillit Drejtues, është në pushim me pagesë për vitin akademik 2024/2025 përkatësisht nga data 01.10.2024 deri me dt. 30.09.2025 lidhur me realizimin e projektit kërkimor "Integrimi Evropian i Kosovës dhe Modelet Evropiane për Mbrojtjen e Komuniteteve Jo – Shumicë", ku gjatë kësaj periudhe kohore të lartpërmendurës i lejohet mbajtja e mësimit online, andaj për të shmangur vonesat në procedurat e shqyrtimit të ankesave nga komisioni dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, u vendos si në dispozitivit të këtij vendimi.

Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi



Vendimi t'i dërgohet: Të lartpërmendurave, Menaxhmentit të UHZ-së, Dekanëve të Njësisë Akadematike, Zyrës së IT, Arkivit të UHZ-së.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. i Br. i No. <u>2657</u>	Nr. i faq/ Br. str i No. pg <u>1</u>	
Data / Datum / Date: <u>15 / 10 / 2024</u> Pejë: Peë		

Senati

Ref. Nr.

Pejë, 15.10.2024

Në bazë të nenit 42, 45, 47 dhe 48 të Statutit të UHZ-së, dhe shqyrtimit të kërkesës nr. 2585 dt. 07.10.2024 të z. Edmond Beqiri – Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Sigurim të Cilësisë për aprovimin e fushave në Universitetin Dimëror Ndërkombëtar UNIWIN 2025, Senati i UHZ-së, në mbledhjen e mbajtur me dt. 14.10.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet kërkesa nr. 2585 dt. 07.10.2024 e z. Edmond Beqiri – Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Sigurim të Cilësisë për aprovimin e fushave në Universitetin Dimëror Ndërkombëtar UNIWIN 2025.
- II. Universitetin Dimëror Ndërkombëtar UNIWIN 2025 do të organizohet në fushat : Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis, nga data 20.01.2025 deri më datë 02.02.2025, në këtë formë:
 - 20.01.2025 – 26.01.2025 online
 - 27.01.2025 – 02.02.2025 fizike
- III. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

Vendimi t'i dërgohet:

- Dekanit të FMTHM-së;
- Prorektorëve të UHZ-së;
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyrës së Financave;
- Zyrës së IT;
- Arkivit të UHZ-së.



Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / B. / No. 2661	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1	
Data / Datum / Date 15.10.2024 Pejë / Poë		

Senati

Ref. Nr.

Pejë, 15.10.2024

Në bazë të nenit 42, 45 dhe 48 të Statutit të UHZ-së, dhe raportit të Komisionit për Botime me nr. prot. 2627 datë 14.10.2024, Senati i UHZ në mbledhjen e mbajtur me dt. 14.10.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet raporti i Komisionit për Botime me nr. prot. 2627 datë 14.10.2024 vetëm për përdorimin e logos së Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë për botimin e librit me titull: "E drejta Gjqësore" nga Prof. Asoc. Dr. Avdullah Robaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

Arsyetim

Senati i UHZ-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 14.10.2024 ka shqyrtuar raportin e Komisionit për Botime lidhur me lejin vetëm të përdorimit të logos së Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, për botimin e librit me titull: "E drejta Gjqësore" me autor Prof. Asoc. Dr. Avdullah Robaj, për arsye se procedurat për pagesë/ financim të botimit janë të pazbatueshme për universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë. Andaj, nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Prof. Asoc. Dr. Avdullah Robaj;
- Prorektorëve të UHZ-së;
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyrës së IT;
- Arkivit të UHZ-së.

Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSHMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJE
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 2697	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 10	
Data / Datum / Date: 16.10.2024 Pejë / Poë		

Senati

Ref. Nr.

Pejë, 14.10.2024

Në bazë të nenit 42, 47, 48, të Statutit të Universitetit, Rregullores për Procedurat Vlerësuese për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve të Jashtëm në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë nr. 1165/22, të dt. 23.05.2022, Konkursit për angazhimin e personelit akademik nr. 2043/24, të dt. 16.08.2024, pas shqyrtimit të rekomandimeve të komisionit të studimeve dhe propozimeve të këshillave të njësive akademike, Senati i UHZ – së, në mbledhjen e mbajtur me dt. 14.10.2024, nxjerrë këtë:

VENDIM

I. Për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në të gjitha njësitë akademike për vitin akademik 2023/24;

FAKULTETI I BIZNESIT

Bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata/ushtime:

1. Sadri Alijaj angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët: Matematika për Biznes dhe Ekonomi (MB, BSc, 6 orë, sem. dimëror, O), Statistika (MB, BSc, 6 orë, sem. pranveror, O);
2. Rishpallet pozita një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndën: Matematika I (TIBE, BSc, 4 orë, sem. dimëror, O), pasi qe kandidatja e paraqitur nuk plotëson kushtet formale-juridike;
3. Kthehet në këshillin e fakultetit për rivendosjes pozita një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndën: Shkrimi Akademik (MB, TIBE, BSc, 6 orë, sem. dimëror, O dhe Z);
4. Samedin Krrabaj angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndën: Bazat e IT-së (MB, BSc, 6 orë, sem. dimëror, O), Dizajni dhe Grafika Kompjuterike (TIBE, BSc, 2 orë, sem. pranveror, Z);
5. Kthehet në këshillin e fakultetit për rivendosjes pozita një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët: Gjuhë Angleze I (TIBE, BSc, 4 orë, sem. dimëror, O), Gjuhë Angleze II (MB, BSc, 3 orë, sem. dimëror, Z), Gjuhë Angleze I (MB, BSc, 6 orë, sem. pranveror, O);
6. Fitim Deari angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët: Analiza dhe Raportimi Financiar (MB, BSc, 3 orë, sem. dimëror, O), Sisteme Informacioni të Kontabilitetit (TIBE, BSc, 2 orë, sem. dimëror, Z), Auditimi i Performancës (MB, MSc, 3 orë, sem. dimëror, Z).
7. Alban Etemi angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët: Banka dhe Sigurime (MB, BSc, 3 orë, sem. dimëror, O), Vlerësimi i Riskut dhe Kontrolli në Korporata (MB, MSc, 3 orë, sem. dimëror, Z), Menaxhimi i Riskut Bankar (MRS, MSc, 2 orë, sem. dimëror, Z), Sigurimi Jetë dhe Jo-Jetë (MRS, MSc, 2 orë, sem. pranveror, Z).

8. Safete Hadergjonaj angazhohet bashkëpunëtoe e jashtme për ligjërata në lëndët: Financat Ndërkombëtare (MB, BSc, 3 orë, sem. dimëror, O), Menaxhimi i PPP-ve (MB, MSc, 3 orë, sem. dimëror, Z), Politika Monetare (MB, MSc, 3 orë, sem. dimëror, Z);
9. Luljeta Glllogjani angazhohet bashkëpunëtoe e jashtme për ligjërata në lëndët: Auditimi i Brendshëm (MB, MSc, 3 orë, sem. dimëror, Z), Auditimi i Avancuar (MB, MSc, 3 orë, sem. dimëror, O);
10. Yvesa Jusaj angazhohet bashkëpunëtoe e jashtme për ligjërata në lëndët: Politikat e E-Rekrutimit dhe Seleksionimit (MBNJ, MSc, 3 orë, sem. dimëror, O), Etika në Biznes (MB, MBNJ, MSc, 3 orë, sem. dimëror, Z).
11. Kthehet në këshillin e fakultetit për rivendosje pozita një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët: Tregtia Elektronike (IB, MSc, 3 orë, sem. dimëror, Z), Menaxhimi i Riskut dhe Siguria Kibernetike (IB, MSc, 3 orë, sem. dimëror, Z);
12. Rishpallet pozita një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët: Menaxhimi i Dijes me Elemente të Intelegjencës Artificiale (IB, MSc, 3 orë, sem. dimëror, Z), Bazat e Programimit (TIBE, BSc, 2 orë, sem. pranveror, Z), Komunikimi Mobil në Biznes (TIBE, BSc, 2 orë, sem. pranveror, Z), pasi qe asnjëri nga kandidatët nuk plotësojnë kushtet formale-juridike;
13. Senad Orhani angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Matematika për Biznes dhe Ekonomi (MB, BSc, 4 orë, sem. dimëror, O), Matematika I (TIBE, BSc, 4 orë, sem. dimëror, O), Statistika (MB, BSc, 4 orë, sem. pranveror, O), Statistika dhe Probabiliteti (TIBE, BSc, 4 orë, sem. pranveror, O);
14. Rishpallet pozita një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Bazat e IT-së (MB, BSc, 4 orë, sem. dimëror, O), Teknologji e Informacionit (TIBE, BSc, 4 orë, sem. dimëror, O), Teknologji të Internetit (TIBE, BSc, 4 orë, sem. pranveror, O), Biznesi Elektronik (TIBE, BSc, 4 orë, sem. pranveror, O), pasi qe kandidati i propozuar është tërhequr;
15. Duresa Kilaj angazhohet bashkëpunëtoe e jashtme për ushtrime në lëndët: Menaxhmenti Financiar i Avancuar (MB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, Z), Investimet dhe Menaxhimi i Portofolit (MB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Politika Monetare (MB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, Z), Menaxhimi i Institucioneve Financiare (MB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Ekonometria Financiare (MB, MSc, 2 orë, sem. pranveror, Z), Menaxhimi i Kompanive të Sigurimit (MRS, MSc, 2 orë, sem. pranveror, O).
16. Aulonë Cenaj angazhohet bashkëpunëtoe e jashtëm për ushtrime në lëndët: Financat e Korporatave (MB, BSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Financat e Avancuara të Korporatave (MB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Qeverisja Korporative (MB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Financat Ndërkombëtare (MB, BSc, 2 orë, sem. dimëror, O);
17. Besa Hajdaraj angazhohet bashkëpunëtoe e jashtme për ushtrime në lëndët: Kontabiliteti Menaxherial (MB, BSc, 2 orë, sem. dimëror, Z), Analiza dhe Raportimi Financiar (MB, BSc, 3 orë, sem. dimëror, O), Sisteme Informacioni të Kontabilitetit (TIBE, BSc, 2 orë, sem. dimëror, Z), Menaxhimi i Riskut Bankar (MRS, MSc, 1 orë, sem. dimëror, Z).
18. Kamer Brahimaj angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Tregtia e Jashtme (MB, BSc, 2 orë, sem. dimëror, Z), Menaxhimi i Projekteve të BE-së (MB, MSc, 3 orë, sem. dimëror, O), Ndërmarrësia dhe Inovacionet (MB, IB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O dhe Z), Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit (IB, MSc, 1 orë, sem. dimëror, Z).

19. Kadë Morina angazhohet bashkëpunëtoe e jashtme për ushtrime në lëndët: Banka dhe Sigurime (MB, BSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Menaxhimi i Kapitalit të Bankave dhe Sigurimeve (MB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, Z), Menaxhimi i Riskut dhe Sigurimet (MB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, Z), Vlerësimi i Riskut dhe Kontrolli në Korporata (MB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, Z), Ekonomia e Sigurimeve (MB, BSc, 2 orë, sem. pranveror, Z), Sigurimet Jetë dhe Jo - Jetë (MRS, MSc, 1 orë, sem. pranveror, Z).
20. Kthehet në këshillin e fakultetit për rivendosje pozita bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Informatikë Biznesi (TIBE, BSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Hyrje në Bazën e të Dhënave (TIBE, BSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Web Dizajni për Biznes (IB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Big Data dhe Cloud Computing (IB, MSc, 1 orë, sem. dimëror, Z), Bazat e Programimit (TIBE, BSc, 2 orë, sem. pranveror, Z), Dizajni dhe Grafika Kompjuterike (TIBE, BSc, 2 orë, sem. pranveror, Z), Projektimi i Bazës së të Dhënave (TIBE, BSc, 2 orë, sem. pranveror, O), Hyrje në Rrjetet Kompjuterike (TIBE, BSc, 2 orë, sem. pranveror, O);
21. Diellza Kukaj angazhohet bashkëpunëtoe e jashtme për ushtrime në lëndët: Auditimi i Brendshëm (MB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, Z), Auditimi i Avancuar (MB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Auditimi i Performancës (MB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, Z);
22. Arjant Topanica angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Lidershipi dhe Vendimmarrja (MB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Etika në Biznes (MB, MBNJ, MSc, 2 orë, sem. dimëror, Z), Menaxhimi i Burimeve Njerëzore (MBNJ, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Lidershipi (MB, BSc, 2 orë, sem. pranveror, O), Menaxhmenti Strategjik i Avancuar (MB, MSc, 2 orë, sem. pranveror, O), Menaxhimi Strategjik i Burimeve Njerëzore (MBNJ, MSc, 2 orë, sem. pranveror, O), Menaxhimi i Dijes (MB, BSc, 2 orë, sem. pranveror, Z).
23. Bardha Mulhaxha Studenica angazhohet bashkëpunëtoe e jashtme për ushtrime në lëndët: Politikat e E-Rekrutimit dhe Seleksionimit (MBNJ, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Planifikimi dhe Organizimi i Trajnimeve (MBNJ, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Menaxhimi i Talentit të Burimeve Njerëzore (MBNJ, MSc, 1 orë, sem. dimëror, Z).
24. Jahja Lataj angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Sistemet e Informacionit të MBNJ-së (MBNJ, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Sisteme Informacioni dhe Komunikimi të Biznesit (IB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Menaxhimi i Projekteve të IT-së (IB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Sisteme Informacioni (MB, BSc, 2 orë, sem. pranveror, O), Komunikimi Mobil në Biznes (TIBE, BSc, 2 orë, sem. pranveror, Z), Menaxhimi i Bazës së të Dhënave (MB, BSc, 2 orë, sem. pranveror, Z), Sisteme të Menaxhimit të Bazës së të Dhënave (IB, MSc, 2 orë, sem. pranveror, O), Sisteme e Informacionit të Menaxhimit (MB, MSc, 2 orë, sem. pranveror, O).
25. Lumë Çollaku angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Fintech në Biznes (MB, BSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Financat Digjitale (MB, IB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O dhe Z), Intelegjenca Biznesore (IB, MSc, 2 orë, sem. dimëror, O), Menaxhimi i Riskut dhe Siguria Kibernetike (IB, MSc, 1 orë, sem. dimëror, O).

ZAHTJEV ZA ANGAŽOVANJE AKADEMSKOG OSOBLJA NA BOSANSKOM JEZIKU ZA AKADEMSKU 2024/2025 GODINU

1. Husnija Bibuljica angazhohet në pozitën jedan predavač za predmete: Osnovi računovodstva (MB, BSc, 3 časa, zimski semester, O), Preduzetništvo i inovacije (MB, MSc, 3 časa, zimski semester, O), Preduzetništvo (MB, BSc, 3 časa, ljetnji semester, O), Lideršip (MB, BSc, 3 časa, ljetnji semester, O);
2. Mejdin Saliji angazhohet në pozitën jedan predavač za predmete: Matematika u biznisu i ekonomiji (MB, BSc, 3 časa, zimski semester, O), Ekonometrija (MB, BSc, 3 časa, zimski semester, O), Statistika (MB, BSc, 3+2 časa, ljetnji semester, O);
3. Rishpallet pozita jedan predavač za predmete: Korporativne finansije (MB, BSc, 3 časa, zimski semester, O), Napredno finansijsko upravljanje (MB, MSc, 3 časa, zimski semester, O), pasi qe nuk ka aplikuar as një kandidatë;
4. Ariana Xhemajli angazhohet në pozitën jedan predavač za predmete: Operacioni menadžment (MB, BSc, 3 časa, zimski semester, O), Upravljanje projektima (MB, BSc, 3 časa, zimski semester, O), Upravljanje stresom i vremenom (MB, BSc, 3+2 časa, ljetnji semester, I);
5. Rishpallet pozita jedan predavač za predmete: Marketing (MB, BSc, 3 časa, zimski semester, O), Upravljanje JPP (MB, MSc, 3 časa, zimski semester, I), pasi qe asnjëri nga kandidatët nuk plotësojnë kushtet formale juridike;
6. Rishpallet pozita jedan predavač za predmete: Engleski jezik II (MB, BSc, 3+2 časa, zimski semester, I), Engleski jezik I (MB, BSc, 3+2 časa, ljetnji semester, O), pasi qe kandidatja e paraqitur nuk plotëson kushtet formale-juridike;
7. Rishpallet pozita jedan asistent za predmete: Osnovi računovodstva (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O), Korporativne finansije (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O), Napredno finansijsko upravljanje (MB, MSc, 2 časa, zimski semester, O), Mikroekonomska analiza (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O), Monetarna ekonomija (MB, BSc, 2 časa, ljetnji semester, I), Totalno upravljanje kvalitetom (MB, MSc, 2 časa, ljetnji semester, O), pasi qe kandidatët e paraqitur nuk plotësojnë kushtet formale-juridike;
8. Rishpallet pozita jedan asistent za predmete: Akademsko pisanje (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O), Kvalitativne metode u naučnom istraživanju (MB, MSc, 2 časa, zimski semester, O), Biznis okoliša (MB, MSc, 2 časa, zimski semester, O), Strateški menadžment (MB, MSc, 2 časa, zimski semester, O), Osnovi menadžmenta (MB, BSc, 2 časa, ljetnji semester, O), Komunikacija u biznisu (MB, BSc, 2 časa, ljetnji semester, O), Lideršip (MB, BSc, 2 časa, ljetnji semester, O), pasi qe kandidatët e paraqitur nuk plotësojnë kushtet formale-juridike;
9. Adel Tahiri angazhohet në pozitën jedan asistent za predmete: Matematika u biznisu i ekonomiji (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O), Ekonometrija (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O), Osnovi IT (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O), Operacioni menadžment (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O), Informacioni sistemi (MB, BSc, 2 časa, ljetnji semester, O), Menadžment informacionih sistema (MB, MSc, 2 časa, ljetnji semester, O);
10. Aneta Dzogovic angazhohet në pozitën jedan asistent za predmete: Marketing (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O), Ekonomija EU i Kosova (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O), Napredna menadžerska ekonomija (MB, MSc, 2 časa, zimski semester, O), Upravljanje JPP (MB, MSc, 2 časa, zimski semester, O), Međunarodni biznis (MB, BSc, 2 časa, ljetnji semester, O);

11. Rishpallet pozita jedan asistent za predmete: Upravljanje projektima (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O), Preduzetništvo i inovacije (MB, MSc, 2 časa, zimski semester, O), Upravljanje projektima EU (MB, MSc, 3 časa, zimski semester, O), Liderstvo i odlučivanje (MB, MSc, 2 časa, zimski semester, O), pasi qe kandidatët e paraqitur nuk plotësojnë kushtet formale-juridike;

FAKULTETI JURIDIK

Bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata/ushtime:

1. Kadri Kryeziu angazhohet bashkëpunëtor për ligjërata në lëndët: Historia e Institucioneve Shtetërore dhe Juridike 6 orë (semestri dimëror); E Drejta Romake 6 orë (semestri veror);
2. Lirak Kajradiu angazhohet bashkëpunëtor për ligjërata në lëndët: Gjuhë Angleze I (semestri dimëror), 4 orë; Gjuhë Angleze II, 4 orë (semestri veror);
3. Afet Mamuti angazhohet bashkëpunëtor për ligjërata në lëndët: E Drejta e Pronësisë (LLM) 3 orë; E Drejta Tregtare (LLB) 2 orë (semestri dimëror); e Drejta Familjare dhe Trashëgimore (LLB) 6 orë; Gjyqësia Civile dhe Komeriale (LLM) 3 orë (semestri veror);
4. Rishpallet pozita një bashkëpunëtor për ligjërata në lëndët: E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane e Mjedisit (LLM) 2 orë; E Drejta Biznesore e Bashkimit Evropian (LLM) 2 orë (semestri dimëror); E Drejta e Pronësisë Intelektuale dhe Teknologjia (LLM) 2 orë; E Drejta Evropiane Administrative 2 orë (semestri veror), pasi qe asnjë kandidatët e paraqitur nuk plotësojnë kushtet formale juridike;
5. Abdulla Azizi angazhohet bashkëpunëtor për ligjërata në lëndët: Sistemi Politik në Kontekstin Evropian 4 orë; Qeverisja Lokale 2 orë (semestri dimëror); E Drejta Kushtetuese Pozitive 3 orë; E Drejta Sociale 3 orë (semestri veror);
6. Granit Elezaj angazhohet bashkëpunëtor për ushtime në grup lëndësh nga E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane;
7. Anulohet pozita bashkëpunëtor për ushtime në grup lëndësh nga E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane, për shkak të mungesës së fondit të orëve;
8. Petrit Hajdari angazhohet bashkëpunëtor për ushtime në grup lëndësh nga E Drejta Kushtetuese - Administrative;
9. Anulohet pozita bashkëpunëtor për ushtime në grup lëndësh nga E Drejta Kushtetuese – Administrative, për shkak të mungesës së fondit të orëve;
10. Besa Demaj angazhohet bashkëpunëtor për ushtime në grup lëndësh nga E Drejta Civile;
11. Arbenita Hussain angazhohet bashkëpunëtor për ushtime në grup lëndësh nga E Drejta Civile;

FAKULTETI I MTHM - së

Bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata/ushtime:

1. Anulohet pozita një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndën: Menaxhimi i Burimeve Ujore 2L/2U, Ekologjia 2L/2U, Drejtimi në Gjuhë Boshnjake (semestri dimëror), për shkak se lëndët mubulohet nga stafi i regullt akademik;

2. Lirak Kajragdiu angazhohet bashkëpunor i jashtëm për ligjerata në lëndën: Gjuhë Angleze 4 L, Drejtimi në Gjuhë Boshnjake, semestri dimëror/4 ore ligjerata Drejtimi në Gjuhën Shqipe (semestri veror);
3. Zahir Arifovic angazhohet bashkëpunor i jashtëm për ligjerata në lëndën: Razvoj Turističkih Proizvoda semestri dimëror 2L/2U;
4. Anulohet pozita një bashkëpunor i jashtëm për ligjerata në lëndën: Turističke Agencije semestri veror 2L/2U, për shkak se lëndët mubulohet nga stafi i rregullt akademik;
5. Arian Gashi angazhohet bashkëpunor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Shkenca Mjedisore (Dimëror /Veror)M];
6. Senad Orhani angazhohet bashkëpunor i jashtëm për ushtrime në lëndën: Matematikë 4U (semestri dimëror);

FAKULTETI I AGROBIZNESIT

Bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata/ushtime:

1. Laura Naka angazhohet bashkëpunëtor e jashtme për ligjërata në lëndët: Gjuhë Angleze, & U (TU, TPB, AA) (Semestri dimëror 4 orë ligjërata + 1 orë ushtrime) ligjërata;
2. Ilmi Hoxha angazhohet bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët: Matematikë, (TU, TPB, AA, MTHM) (Semestri dimëror 5 orë ligjërata);
3. Rishpallet pozita një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët: Fizikë, TU (Semestri dimëror 2 orë ligjërata + 2 orë ushtrime) (TU), pasi qe kandidati i paraqitur nuk plotëson kushtet formale juridike;
4. Rishpallet pozita një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët: Informatikë e Aplikuar në Buqësi, (AA, TPB), Teknologji e Informacionit, (TU) (Semestri dimëror 4 orë ligjërata 1 orë ushtrime), pasi qe kandidatët e paraqitur nuk plotësojnë kushtet formale juridike;
5. Demë Abazi angazhohet bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët: Hidrologjia&Hidroteknik (Semestri veror 2 orë ligjërata + 2 orë ushtrime), Parimet dhe Praktika e Ujitjes (Semestri veror 2 orë ligjërata + 2 orë ushtrime);
6. Vlora Gashi angazhohet bashkëpunëtor e jashtme për ligjërata në lëndët: Trajtimi i Tokës dhe Mbetjeve (Semestri veror 2 orë ligjërata + 2 orë ushtrime);
7. Murat Hulaj angazhohet bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët: Qeverisja, Politikat dhe Legjislacioni në Sektorin agro-ushqimor (Semestri dimëror 2 orë ligjërata + 2 orë ushtrime) (MA);
8. Renata Kongoli angazhohet bashkëpunëtor e jashtme për ligjërata në lëndët: Teknologjia e Qëndrueshme e Produkteve të Përpunimit të Frutave dhe Perimeve MA (Semestri dimëror 2 orë ligjërata 2 orë ushtrime);
9. Filipos Ruxho angazhohet bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët: Marketingu i Produkteve të Qëndrueshme agro-ushqimore MA (Semestri dimëror 2 orë ligjërata 2 orë ushtrime). Menaxhimi i zonave të mbrojtura MA (Semestri dimëror 2 orë ligjërata);

10. Violeta Berljolli angazhohet bashkëpunëtorë e jashtme për ligjërata në lëndët: Konservimi (ruajtja) e Biodiversitetit MA (Semestri dimëror 2 orë ligjërata 2 orë ushtrime);
11. Faruk Bojaxhiu angazhohet bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët: Ekologjia e Pyjeve MA (Semestri dimëror 2 orë ligjërata 2 orë ushtrime);
12. Fejzullah Beha angazhohet bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët: Planifikimi Hapësinor MA (Semestri dimëror 2 orë ligjërata 1 orë ushtrime);
13. Jetmir Prekalla angazhohet bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime në lëndët: Bioteknologji Ushqimore (Semestri veror 2 orë ushtrime), Teknologjia e Prodhimit të Birrës (Semestri dimëror 2 orë ushtrime), Përpunimi i Ushqimit me Prejardhje Bimore (Semestri dimëror 2 orë ushtrime), Teknologjia e Drithërave TPB (Semestri dimëror 2 orë ushtrime), Teknologjia e Drithërave TU (Semestri veror 2 orë ushtrime);
14. Violeta Berljolli angazhohet bashkëpunëtorë e jashtme për ushtrime në lëndët: Biologji TU (Semestri dimëror 4 orë ushtrime), Zoologji A&A (Semestri veror 2 orë ushtrime), Mikrobiologji Bujqësore (Semestri dimëror 2 orë ushtrime), Mikrobiologji (Semestri veror 2 orë ushtrime);
15. Kthehet në këshillin e fakultetit për rivendosje pozita një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime në lëndët: Pedologjia (A&A, TPB) (Semestri veror 4 orë ushtrime), Teknologjia e Kultivimit (Semestri veror 2 orë ushtrime), Të Ushqyerit e Bimëve TPB & AA (Semestri dimëror 2 orë ushtrime);
16. Senad Orhani angazhohet bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime në lëndët: Matematikë, (TU, TPB, AA) (Semestri dimëror 4 orë ushtrime);
17. Zenun Krasniqi angazhohet bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime në lëndët: Mikrobiologji Ushqimore dhe Higjiena (Semestri veror 2 orë ushtrime), Kontrolli & Sigurimi i Cilësisë në Industrinë Ushqimore (Semestri veror 1 orë ushtrime), Proceset Themelore në Teknologjinë Ushqimore (Semestri dimëror 2 orë ushtrime), Teknologjia e Pijeve Alkoolike dhe Vërës TU, (Semestri dimëror 2 orë ushtrime), Zhvillimi i Sistemit të Cilësisë, Menaxhimit dhe Vlerësimit të Afatit të Qëndrueshmërisë së Ushqimit MA (Semestri veror 2 orë ushtrime);
18. Gresa Ahma angazhohet bashkëpunëtorë e jashtme për ushtrime në lëndët: Teknologjia e Prodhimit të Maltit TU (Semestri veror 2 orë ushtrime), Teknologjia e Produkteve të Pjekjes (Semestri veror 1 orë ushtrime), Ambalazhimi & Ruajtja e Produkteve Ushqimore (Semestri dimëror 1 orë ushtrime), Bioteknologjia dhe Mbrojtja e Ambientit (Semestri dimëror 2 orë ushtrime), Teknologjia për Përpunimin e Maltit TPB (Semestri dimëror 2 orë ushtrime), Teknologjia e Pasvjeljes AA (Semestri dimëror 2 orë ushtrime);
19. Diellza Taraku angazhohet bashkëpunëtorë e jashtme për ushtrime në lëndët: Mbrojtja Integrale (Semestri veror 2 orë ushtrime), Entomologjia (Semestri dimëror 2 orë ushtrime), Mbrojtja e Bimëve (Semestri dimëror 2 orë ushtrime), Fitopatologjia TPB (Semestri dimëror 2 orë ushtrime), Përdorimi i Qëndrueshëm i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve MA (Semestri dimëror 2 orë ushtrime);

20. Diellza Dresha angazhohet bashkëpunëtorë e jashtme për ushtrime në lëndët: Bazat e Perimtarisë (Semestri veror 2 orë ushtrime), Lavertaria Speciale (Semestri veror 2 orë ushtrime), Bujqësia Organike (Semestri veror 2 orë ushtrime). Përmirësimi Gjenetik A&A (Semestri veror 2 orë ushtrime) dhe Përmirësimi Gjenetik i Bimëve TPB (Semestri dimëror 2 orë ushtrime), Bazat e Gjenetikës TPB (Semestri veror 2 orë ushtrime), Gjenetikë AA (Semestri dimëror 2 orë ushtrime);
21. Dijesa Morina angazhohet bashkëpunëtorë e jashtme për ushtrime në lëndët: Ekologjia Bujqësore TPB, AA (Semestri veror 2 orë ushtrime). Fitoteknia TPB (Semestri dimëror 2 orë ushtrime), Ndotja e Mjedisit AA (Semestri veror 2 orë ushtrime). Menaxhimi i Cilësisë së Ujrave AA (Semestri dimëror 2 orë ushtrime). Ekologji I dhe II AA (Semestri dimëror 2 orë ushtrime). Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis AA (Semestri dimëror 2 orë ushtrime). Ekologjia e Resurseve Natyrore, AA (Semestri veror 2 orë ushtrime);
22. Rinor Krasniqi angazhohet bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime në lëndët: TU Mbrojtja e Prodhimeve Bimore (Semestri veror 1 orë ushtrime). TU Mbrojtja e Ushqimit (Semestri veror 1 orë ushtrime). Bazat e Metodës Instrumentale TU (Semestri dimëror 1 orë ushtrime). Bazat e Toksikologjisë TU (Semestri veror 2 orë ushtrime);
23. Diellza Panxha angazhohet bashkëpunëtorë e jashtme për ushtrime në lëndët: Bimë Aromatike dhe Medicinale TPB (Semestri dimëror 1 orë ushtrime) Administrim dhe Menaxhim Tokë AA (Semestri dimëror 2 orë ushtrime), Degradimi i Tokës AA (Semestri dimëror 2 orë ushtrime) Bimë Aromatike AA (Semestri veror 1 orë ushtrime);
24. Egzon Nikqi angazhohet bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime në lëndët: Teknologjia e Përpunimit të Ujit të Pijshëm TU (Semestri dimëror 2 orë ushtrime). Teknologjia e Proceseve Fermentuese TU (Semestri veror 2 orë ushtrime). TU Bio Prodhimet (Semestri veror 1 orë ushtrime). Metodologjitë dhe Mjetet e Hulumtimit MA (Semestri dimëror 2 orë ushtrime);
25. Sajmir Dinaj angazhohet bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime në lëndët: Menaxhimi i Mbeturinave në Bujqësi dhe Industrinë Ushqimore MA (Semestri dimëror 2 orë ushtrime). Etika Ushqimore MA (Semestri dimëror 2 orë ushtrime). Cilësia dhe Qëndrueshmëria e Prodhimit Ushqimor nga Resurset Bimore MA (Semestri veror 2 orë ushtrime). Teknologjia e Qëndrueshme e Produkteve të Pjekjes MA (Semestri dimëror 2 orë ushtrime). Sistemet e Gjurmimit të Produkteve Ushqimore MA (Semestri veror 2 orë ushtrime);
26. Arian Gashi angazhohet bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për grup lëndësh MA shkenca mjedisore (sem. dimëror dhe verorë);

FAKULTETI I ARTEVE

Bashkëpunëtor të jashtëm për ligjëratat:

1. Ersan Jonuzaj angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ligjëratat për lëndët: Forma muzikore 1-2+0, Forma muzikore 3-2+0, Polifoni 1-2+0/ semestri dimëror 6 orë, Forma muzikore 2-2+0, Forma muzikore 4-2+0, Polifoni 2-2+0, Analizë e veprave muzikore Emm-2+0, Semestri veror 8 orë;

2. Rishpallet pozita një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët: Bazat e orkestrimit 1- 2+0, Aranzhim 1-2+0 semestri dimëror 4 orë, Bazat e orkestrimit 2- 2+0, Aranzhim 2-2+0 semestri veror 4 orë, për shkak të ndarjes nga jeta të kandidatit të propozuar;
3. Ruzhdi Kadrijaj angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët: Bazat e Psikologjisë(Em,Eai)- 2+0,Psikologji -zgjedhore Emm-2+0 semestri dimëror 4 orë semestri veror 0 orë;
4. Behxhet Gaxhiqi angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët: Didaktikë -2+0, Bazat e pedagogji së përgjithshme-2+0, semestri veror 4 orë semestri dimëror 0 orë;
5. Bujar Sykja angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët: Violinë 7-2+0, Pedagogji 1 (mësim praktik)2+0, Praktike koncertale 3- 2+0, semestri dimëror 6 orë, Violinë 8-2+0 Praktike koncertale 4- 2+0 Pedagogji 2 (mësim praktik)-2+0 semestri veror 6 orë;
6. Arben Basha angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët: Kontrabas 7-2+0, edagogji 1 (mësim praktik) -2+0, Praktike koncertale 2- 2+0 semestri dimëror 6 orë Kontrabas 8-2+0, Pedagogji 2 (mësim praktik) -2+0, Praktike koncertale 2- 2+0 semestri veror 6 orë;
7. Lejla Beqiri Vula angazhohet bashkëpunëtor e jashtme për ligjërata për lëndët: Metodologji e zhvillimit kërkimor -2 Em-2+0 semestri dimëror 2 orë Metodologji e hulumtimit eai-2+0 semestri veror 2 orë;
8. Zana Abazi Ramadani angazhohet bashkëpunëtor e jashtme për ligjërata për lëndët: Studio operistike 1-2+0, Lëvizje skenike -2+0 semestri dimëror 4 orë Regji operistike-2+0, Studio operistike 2-2+0, Lëvizje skenike -2+0 semestri veror 6 orë;
9. Xhevdet Sahatxhija angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët: Kitarë 5,7-2+0,Praktikë koncertale 3- 2+0,Pedagogji në instrument 1-1+0, Pedagogji (mësim praktik)-2+0 semestri dimëror 9 orë Kitarë 6,8-2+0, Praktike koncertale 4- 2+0, Pedagogji (mësim praktik)-2+0, semestri veror 8 orë;
10. Gjuljan Bytyqi angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët: Literature e kitarës 1- 2+0, Ansambël i kitarëve 1- 2+0, Jazz kitarë 1-1+0, Jazz improvizim-1+0 semestri dimëror 6 orë, Literature e kitarës 2- 2+0, Ansambël i kitarëve 2- 2+0, Jazz improvizim-1+0, Jazz kitarë 2-1+0 semestri veror 6 orë;
11. Lirak Kajragdiu angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët: Gjuhe angleze 1 Em Eai-zgjedhore 2+0 semestri dimëror 2 orë Gjuhe angleze 2 Em Eai-zgjedhore 2+0 semestri veror 2 orë;
12. Anulohet pozita një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët: Teknologji e informacionit 1 (Zgjedhore) 2+0 semestri dimëror 2 orë Teknologji e informacionit 2 (Zgjedhore) 2+0 semestri veror 2 orë, pasi qe asnjëri nga kandidatët e paraqitur nuk plotësojnë kushtet formale-juridike;
13. Dardan Lajqi angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët: Sociologji e artit1- zgjedhore 2+0 semestri dimëror 2 orë semestri veror 0 orë;
14. Rishpallet pozita një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët: Pedagogji muzikore - Emm 2+0, Pedagogji e mësimit të muzikës -Em 2+0, semestri dimëror 4 orë Pedagogji e mësimit të muzikës -Em -2+0 semestri veror 2 orë, pasi qe konkursin e parë nuk ka aplikuar as një kandidat;
15. Denita Dedushaj angazhohet bashkëpunëtor e jashtme për ligjërata për lëndët: Koorepetim 1-1+0 Korepetim 1 -zgjedhore Em-1+0 semestri dimëror 6 orë Koorepetim 2-1+0 Korepetim 2-zgjedhore Em-1+0 semestri veror 6 orë;
16. Zana Badivuku Basha angazhohet bashkëpunëtor e jashtme për ligjërata për lëndët: Solfezh 1-2+0, Solfezh 3-(Em)-2+0, Metodikë e solfezhit (Emm)-2+0, semestri dimëror 8 orë Solfezh 2-2+0, Solfezh 4-2+0, semestri veror 4 orë;
17. Sokol Saraqi angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët: Menaxhim i artit muzikor(zgj,eai)-2+0, Analizë e stileve muzikore -2+0, Metodika dhe praktika e

solfezhit 2+0, semestri dimëror 6 orë Menaxhim i eventeve muzikore (zgj em)-2+0
Analizë e stileve muzikore -2+0 semestri, Metodika dhe praktika e teorisë muzikore 2+0,
veror 6 orë;

18. Adonis Gjini angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët: Violonqelo
1-4+0 semestri dimëror 4 orë Violonqelo 2-4+0 semestri veror 4 orë;

II. Obligohen Dekanët e njësive akademike që të ju caktojnë një mbikëqyrës më thirrje akademike se paku (prof. ass. dr) bashkëpunëtorëve të jashtëm të cilët mbajnë ligjërata në nivelin master, të cilët nuk kanë thirrje akademike.

Vendimi t'i dërgohet:

- Prorektorit për çështje akademike
- Prorektorit për Buxhet Financa dhe Infrastrukturë
- Dekanëve të njësive akademike
- u. d Sekretarit të Përgjithshme
- Drejtorit për mësimdhënie dhe çështje akademike
- Drejtorit të Financave
- Zyrës së Personelit
- Sekretarëve të njësive akademike
- Arkivit të UHZ-së

Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJE
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 3021	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 16	
Data / Datum / Date: 18.11.2024		Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Senati

Pejë. Dt. 18.11.2024

Në bazë të nenit 42, 47 dhe 48 të Statutit nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me dt. 18.11. 2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** Rregullorja për Studimet e Doktoratës .
- II. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja me nr. prot. 369/20 të datës 18.02.202 për Studimet e Doktoratës
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për Studimet e Doktoratës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryesues i Senatit/

Prof. Dr. Armand Krashiqi

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Rektorit, Anëtarëve të Senatit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Zyrës për IT- së, Arkivës së UHZ-së.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Në mbështetje të nenit 128 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe dispozitat e Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Senati i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më dt. 18.11.2024 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR STUDIMET E DOKTORATËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë rregullore rregullohet organizimi dhe realizimi i studimeve të doktoratës në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë (në vazhdim: Universiteti), institucioni përgjegjës për organizimin e studimeve, format dhe kohëzgjatja e studimeve, kriteret për regjistrim në studime, mënyra e realizimit të studimeve, mësimi dhe hulumtimi, procedura e paraqitjes, vlerësimit dhe mbrojtjes së punimit të doktoratës, të drejtat dhe obligimet e studentit në studime të doktoratës (në vazhdim: doktoranti), të drejtat dhe obligimet e mentorit, mënyrat e sigurimit të cilësisë dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me organizimin dhe realizimin e studimeve të doktoratës.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Dispozitata e kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjithë personat që janë të përfshirë në veprimtaritë e përcaktuara në këtë rregullore.

Përkufizimet

Neni 3

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1. **"KQSD"** – nënkupton Këshillin Qendror të Studimeve të Doktoratës. Këshilli qendror i studimeve të doktoratës e ka këtë përbërje;
 - Rektori
 - Prorektori për mësimdhënie, çështje studentore dhe kërkime shkencore;
 - Një përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës;
 - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave bio teknologjike;
 - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave të Biznesit;
 - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave juridike;
 - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave të turizmit

- Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i arteve.
 - Një student i studimeve të doktoratës;
 - Drejtori i Zyrës Qendrore të studimeve të doktoratës, pa të drejtë vote.
- 1.1. Anëtarët e Këshillit qendror të studimeve të doktoratës i propozon Rektori dhe i zgjedh Senati.
- 1.2. Këshillin qendror të studimeve të doktoratës e kryeson Rektori.
2. **“KSD”** – nënkupton Këshillin e Studimeve të Doktoratës në kuadër të njësisë akademike. Në fillim formohet Këshilli i përkohshëm i studimeve të doktoratës i njësisë akademike nga të gjithë profesorët në studimet e doktoratës, një student dhe koordinatori i zyrës së doktoratës, e pas një viti pune zgjedhet Këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike, nga një numër prej 5-7 anëtarësh nga radhët e profesorëve nga secili departament i njësisë akademike dhe një student i studimeve të doktoratës. Mbledhjen e parë (konstituive) e fton dhe e udhëheqë dekani i njësisë akademike. Pas konstituimit të Këshillit të studimeve të doktoratës të njësisë akademike, Këshilli nga radhët e veta e zgjedh kryetarin.
3. **“KPSD”** – nënkupton Këshillin e përkohshëm të studimeve të doktoratës.
4. **“Institucioni përgjegjës i studimeve”** - nënkupton një a më shumë njësi akademike ose një a më shumë Universitete brenda dhe jashtë vendit, të cilat organizojnë dhe realizojnë studime të doktoratës dhe e përfundojnë procedurën e arritjes së doktoratës shkencore/artistike.
5. **“Mentori”** – nënkupton personin e emëruar, me titull shkencor-mësimor ose artistik-mësimor, i cili e udhëheq doktorantin gjatë punimit të disertacionit të doktoratës.
6. **“Komentor”** – është një person që udhëheqë kandidatin si bashkëmentor, i cili jep vlerësime, komente ose analiza në lidhje me një temë ose cdo material tjetër. Komentori mund të jetë mësimdhënës i punësuar në UHZ, apo ndonjë universitet tjetër.
7. **“Komentor industrial”** – është një person që përkrahë dhe këshillon kandidatin në aspektin e kontributit të disertacionit në sektor.
8. **“Dosja e doktorantit”** – nënkupton dosjen e cila i përmban të gjitha shënimet qenësore të doktorantit, prej momentit të pranimit të tij e deri te promovimi.
9. **“Njësia akademike”** – nënkupton njësinë akademike në të cilën është regjistruar studenti, e cila është përgjegjëse për mbledhjen dhe për ruajtjen e të dhënave në dosje sipas formularëve të hartuar.

Neni 4

1. Studime të doktoratës ofrojnë njësitë akademike (fakultetet) dhe/ose Universiteti/universitetet në një apo më shumë lëmenj shkencorë, nëse kanë kontratë të nënshkruar për marrëdhënie pune me orar të plotë me më së paku gjysmën e numrit të mësimdhënësve të angazhuar në atë program studimi.
2. Karakteristikat themelore të studimeve të doktoratës në Universitet janë hulumtimi dhe të mësuarit nëpërmjet hulumtimit, ndërkombëtarizimi, transparenca, vlerësimi ndërkombëtar i cilësisë dhe konkurrenca ndërkombëtare.
3. Me qëllim të sigurimit të cilësisë dhe nxitjes së lëvizshmërisë së doktorantëve dhe të mësimdhënësve, studimet e doktoratës janë të hapura për çdo formë të bashkëpunimit me institucione të ngjashme brenda dhe jashtë vendit.

Mësimi dhe hulumtimi në studimet e doktoratës

Neni 5

1. Komponenti thelbësor i studimeve universitare të doktoratës është kërkimi dhe krijimi shkencor/artistik.
2. Format e punës në studimet e doktoratës janë ligjeratat, ushtrimet laboratorike, puna kërkimore laboratorike, seminarët kërkimore, punëtoritë dhe grupet e diskutimit, me qëllim të zhvillimit të punës kërkimore, mendimit kritik, përvetësimit të metodologjisë dhe shkathtësive të përgjithshme.
3. Mësimi në formë të ligjeratave nuk bën ta kalojë 20 përqindëshin e ngarkesës së përgjithshme të paraparë me programin e studimeve dhe të llogaritur sipas sistemit evropian të transferimit të kredive (ECTS).
4. Sipas mundësive dhe në bazë të kushteve të përcaktuara paraprakisht, ndjekja e mësimi në studimet e doktoratës është e hapur për të gjithë doktorantët e Universitetit. Disa pjesë të kërkimeve dhe të mësimi në studimet e doktoratës mund të ndiqen edhe nga doktorantët e Universiteteve të tjera, sipas kushteve të parapara në kontratën e nënshkruar paraprakisht ndërmjet Universiteteve në fjalë.
5. Me qëllim të arritjes së interdisiplinaritetit dhe në bazë të arsyeshmerisë dhe pëlqimit të mentorit, si dhe të pëlqimit të Këshillit të studimeve të doktoratës, doktorantët mund të kryejnë pjesë të caktuara të kërkimit dhe të krijimtarisë artistike edhe në njësitë e tjera akademike të Universitetit ose në institucione të tjera përkatëse brenda dhe jashtë vendit.
6. Këshilli i studimeve të doktoratës mund t'u caktojë doktorantëve lëndë plotësuese nga grupi i lëndëve brenda programit të akredituar për arritjen e diturive themelore, të domosdoshme për vijimin dhe për përfundimin e studimeve.

Format e studimeve të doktoratës

Neni 6

1. Studimet e doktoratës mund të organizohen në njërin prej këtyre formave:
 - 1.1. Studimet e doktoratës, për të cilat institucioni përgjegjës është vetëm një njësi akademike ose universiteti;
 - 1.2. Studimet e përbashkëta të cilat i realizojnë dy apo më shumë universitete, nga të cilat vetëm njëri institucion është institucion përgjegjës.
 - 1.3. Doktorata e dyfishtë, në të cilën doktoranti i merr dy diploma dhe për të cilën është i obliguar edhe mentorimi i dyfishtë (modeli: cotutelle de thèse). Aplikohet në rastet kur me marrëveshje të veçantë, doktoranti regjistrohët në studimet e doktoratës në dy universitetet partnere, dhe të dy universitetet emërojnë mentorin përkatës për doktorantin. Procedurat e regjistrimit të doktorantëve dhe realizimit të studimeve të doktoratës parashihen në marrëveshjen e veçantë të lidhur ndërmjet dy universiteteve.
 - 1.4. Modeli në të cilin doktoranti i regjistron studimet në një universitet dhe e merr diplomën e institucionit përgjegjës të studimeve, ndërsa kërkimet i kryen në më shumë institucione dhe mund të ketë bashkëmentorë.
 - 1.5. Studimet e përbashkëta si program i akredituar i dy ose më shumë universiteteve, nga të cilat së paku një universitet është jashtë Republikës së Kosovës, ku secili universitet merr pjesë në regjistrimin e doktorantëve, ndërsa doktoranti mund të fitojë diplomë të vetme të dy ose më shumë universiteteve,

- ose diplomën e universitetit në të cilin i ka regjistruar studimet e doktoratës, e në të cilën shkruan se studimet kanë qenë të përbashkëta.
2. Nuk lejohet transferimi i studimeve të doktoratës nga një njësi akademike në tjetrën brenda Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, e as nga universitetet e tjera në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë. Studentët pranohen vetëm në bazë të konkursit të shpallur nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë.

Kushtet e regjistrimit dhe kohëzgjatja e studimeve

Neni 7

1. Në pajtim me kushtet e përcaktuara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, njësitë akademike propozojnë numrin e studentëve për regjistrim, ndërsa senati merr vendimin përfundimtar për numrin e studentëve dhe shpalljen e konkursit publik, duke pasur parasysh kapacitetet hulumtuese, mësimore dhe të mentorimit të njësisë akademike.
2. Konkursi për regjistrim në studimet e doktoratës shpallet nga senati i universitetit me kërkesë të njësisë akademike, së paku tre muaj para fillimit të vitit akademik, i cili publikohet në uebfaqen e Universitetit "Haxhi Zeka", dhe zgjatë dy muaj.
3. Të drejtë konkurrimi për regjistrim në studimet e doktoratës kanë kandidatët me notë mesatare jo më të ultë se 8.00 në secilin nivel të studimeve paraprake baqelor dhe master veç e veç, të diplomuar në njërin nga nivelet vijuese:
 - 3.1. Të diplomuarit para hyrjes në fuqi të studimeve sipas Deklaratës së Bolonjës, të cilët duhet të jenë magjistër të shkencës përkatëse;
 - 3.2. Të diplomuarit pas hyrjes në fuqi të studimeve në bazë të Deklaratës së Bolonjës - niveli i studimeve master shkencor;
 - 3.3. Të diplomuarit që kanë së paku 300 ECTS kredi (European Credit Transfer System);
 - 3.4. Përrjashtimisht nga pika 3.1, 3.2 dhe 3.3, në rast se kandidatët vijnë nga jashtë sistemit të Bolonjës, për bazë do të merret nostrifikimi i ministrisë përkatëse.
4. Kriteret e vlerësimit të kandidatëve për regjistrim në studimet e doktoratës përfshijnë:
 - 4.1. Kandidatët duhet t'i kenë të përfunduara studimet paraprake në fushën e njëjtë ose të afërt me studimet e doktoratës. Fushat e afërta përcaktohen nga Këshilli i doktoratës së njësisë përkatëse akademike, dhe vlejnë për tërë periudhën e akreditimit të programit përkatës, të cilat publikohen në konkurs në kuadër të seksionit të kushteve të veçanta për njësinë akademike përkatëse. Vlerësimi i fushës së kandidatit bëhet nga Këshilli i doktoratës së njësisë përkatëse akademike para se t'i nënshtrohen provimit pranues.
 - 4.2. Suksesi në shkollimin gjatë studimeve, nota mesatare 8.00 e më lart në të dy nivelet baqelor dhe master (magjistër) veç e veç. Përkatësisht nota mesatare e studimeve të integruara, vlerësohet maksimalisht me 30 pikë, të cilat llogariten duke shumëzuar notën mesatare aritmetike të studimeve baqelor dhe master me 3.
 - 4.3. Dëshmi për njohjen e gjuhës angleze. Kriteret e vlerësimit të njohjes së gjuhës angleze janë të njëjta për të gjitha njësitë akademike. Çdo kandidat duhet të dëshmojë zotërim të gjuhës angleze, së paku në nivelin B2. Kandidatët të cilët kanë dëshmi nga testet e njohura ndërkombëtarisht, TOEFL dhe IELTS, të cilat janë administruar nga institucione të akredituara sipas Komisionit Evropian të

Referencës për Gjuhët (CEFR) duhet të dëshmojnë se kanë arritur këto rezultate: për TOEFL, rezultati 72 pikë jep 10 pikë, ndërsa për IELTS, minimumi 5.5 jep 10 pikë. Të shprehura me shifra janë si në vijim: për TOEFL, 72-79 = 10 pikë, 80-87 = 15 pikë, mbi 88 = 20 pikë. Ndërsa për IELTS, 5.5 = 10 pikë, 6.0=15 pikë, mbi 6.5 = 20 pikë. Njohuria e gjuhës angleze vlerësohet maksimalisht me 20 pikë. Kandidatët që nuk paraqesin dëshmi të TOEFL-it dhe IELTS-it, iu nënshtrohen provimit pranues për gjuhën angleze në nivelin B2, i cili organizohet nga universiteti, sipas orarit të shpallur në konkurs për pranim të studentëve të doktoratës.

4.4. Aktivitetet shkencore/artistike të botuara vlerësohen deri në 20 pikë maksimale:

4.4.1. Për çdo artikull të publikuar në pesë vitet e fundit dhe të indeksuar në platformën Web of Science (SCIE, SSCI dhe AHCI) dhe/ose SCOPUS (Q1, Q2, Q3, Q4): autori i parë/korrespondent 5 pikë, të tjerët 2 pikë.

4.4.2. Për çdo artikull të botuar në pesë vitet e fundit në revista të tjera ndërkombëtare të indeksuara në platformat e specifikuara në rregulloren në fuqi për procedurat përzgjedhëse lidhur me personelin akademik: autori i parë/korrespondent 3 pikë, të tjerët 1 pikë.

4.4.3. Për çdo artikull të publikuar në pesë vitet e fundit në revista akademike vendore të cilat i nënshtrohen recensionit profesional: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë.

4.4.4. Për libër universitar të botuar në pesë vitet e fundit nga lëmi e ngushtë: autori i parë 5 pikë, bashkautori 3 pikë. Monografia e botuar në fushën ku aplikon kandidati vlerësohet me 4 pikë.

4.4.5. Për çdo prezantim të punimit në pesë vitet e fundit në konferenca, kongrese, apo simpoziume ndërkombëtare shkencore të indeksuara dhe të botuara në përmbledhjen e punimeve: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë.

4.4.6. Për çdo prezantim në pesë vitet e fundit në konferenca, kongrese, apo simpoziume shkencore vendore: autori i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë.

4.5. Provimi pranues organizohet dhe administrohet nga njësitë akademike, duke respektuar standardet më të larta akademike. Në rastet e prezencës së konfliktit të interesit, duhet të evitohet përfshirja e personelit përkatës në të gjitha fazat e provimit pranues. Nëse ka situata të tilla, senati i universitetit mund të kërkojë nga fakulteti të marrë masa shtesë për të evituar diskreditimin e provimit pranues.

4.6. Kandidatët ftohen në intervistë nëse komisioni përkatës i fakultetit paraprakisht konstaton se ata plotësojnë kushtet e konkursit dhe kanë dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm të plotësuar.

4.7. Provimi pranues përfshin provimin lidhur me aspektin profesional/shkencor. Nga provimi pranues profesional, kandidatët mund të fitojnë maksimalisht 30 pikë.

4.8. Projekt propozim i tezave të doktoratës nga lëmi përkatës ku aplikon, dhe intervista e kandidatit, vlerësohet me 40 pikë maksimale.

4.9. Kandidatët renditen në listë sipas pikëve të fituara, dhe përzgjedhja e kandidatëve të pranuar bëhet në bazë të pikëve të grumbulluara, duke marrë parasysh numrin e studentëve të përcaktuar për regjistrim nga senati i Universitetit.

5. Pas propozimit të njësisë akademike dhe pas shqyrtimit në Këshillin Qendror të Studimeve të Doktoratës, senati i universitetit miraton listën për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës. Emrat e kandidatëve të pranuar me të gjitha të dhënat e kritereve të përzgjedhjes, shpallen publikisht në uebfaqen e universitetit.

6. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tre e jo më shumë se gjashtë vite. Pas regjistrimit të semestrit të gjashtë, studenti e fiton statusin e studentit i cili është i vlefshëm deri në tri vite të ardhshme.
7. Në rast se një kandidat për doktoratë nuk arrin të përfundojë me sukses studimet e doktoratës, Universiteti "Haxhi Zeka" lëshon një certifikatë e cila do të raportojë për lëndët që kandidati i ka përfunduar me ECTS kredi përkatëse.
8. Studimet e doktoratës numërojnë njëqind e tetëdhjetë (180) ECTS kredi. Në rast se cilësia e punimit të doktoratës, e vlerësuar me raportet vjetore të progresit të cilat i zbaton Këshilli i studimeve të doktoratës, nuk i plotëson kriteret e parapara, Këshilli i studimeve të doktoratës mund t'i propozojë Këshillit të njësisë akademike, e ky Senatit, të marrë vendim që doktorantit t'ia marrë të drejtën për t'i vazhduar studimet.
9. Me qëllim të rregullimit të çështjeve të mundshme kontestuese, pas pranimit të kandidatit në studimet e doktoratës, nënshkruhet Kontrata midis Universitetit "Haxhi Zeka", studentit të doktoratës dhe mentorit (bashkëmentorëve).
10. Kusht për fitimin e titullit Doktor shkencë është përfundimi me sukses i studimeve të doktoratës dhe mbrojtja me sukses e tezës së doktoratës para Komisionit të mbrojtjes.

Kohëzgjatja dhe fazat e studimeve të doktoratës

Neni 8

1. Studimet e doktoratës janë të organizuara si studime me orar të plotë, duke zgjatur jo më pak se tre vite dhe të ndarë në gjashtë semestra. Përfundimi i këtyre studimeve shoqërohet me mbrojtjen publike të temës së doktoratës brenda një afati prej gjashtë (6) vjetësh nga data e regjistrimit në Universitetin "Haxhi Zeka".
2. Studimet e doktoratës mund të vazhdojnë edhe për një vit të shtuar nga Këshilli i Studimeve të Doktoratës të njësisë akademike me një arsyetim të pranueshëm nga kandidati. Nëse brenda kësaj periudhe, kandidati nuk arrin të përfundojë studimet e doktoratës me sukses, duke përfshirë edhe mbrojtjen publike të punimit të tij, ai ose ajo humb statusin e doktorantit.
3. Përjashtim nga kjo bëjnë kandidatët të cilët gjatë periudhës së studimeve të doktoratës bëhen prind. Në këto raste, pas paraqitjes së fakteve pranë Këshillit të studimeve të doktoratës, kandidatës/kandidatit në fjalë i lejohet vazhdimi i studimeve edhe për një vit të shtuar.
4. Në rast se kandidati humb statusin e doktorantit, Universiteti "Haxhi Zeka" lëshon një certifikatë që e vërteton këtë, së bashku me dëshmi për kurset e përfunduara. Çertifikata e lëshuar nënshkruhet nga dekani i fakultetit përkatës.
5. Me një kërkesë specifike të paraqitur nga kandidati dhe miratimin e mentorit, kandidati mund të hyjë në studime me orar jo të plotë për një periudhë prej jo më shumë se dy vite akademike të përsëritura në rradhë (përveç një viti akademik me orar të plotë), dhe jo më shumë se tre vite në total gjatë gjithë periudhës së studimeve. Në rastet e tilla, kërkesa e kandidatit duhet të miratohet nga Këshilli i Studimeve të Doktoratës në njësinë akademike.
6. Organizimi dhe implementimi i plan-programit për semestrin e parë dhe të dytë janë në përgjegjësi të përgjegjësit ose koordinаторit të programit të caktuar nga njësia akademike. Në fillim të semestrit të dytë, doktoranti, në konsultim me mentorin potencial, propozon projekt-propozimin e doktoratës dhe mentorin (Formulari F1). Propozimi i kandidatit për temë dhe për mentor shqyrtohet dhe miratohet nga Këshilli i Fakultetit, duke u bazuar në vlerësimin e Këshillit të Doktoratës të njësisë. Pas

aprovimit të projekt-propozimit, doktoranti grumbullon 10 ECTS kredi. Këshilli i Fakultetit mund të rekomandojë rishikimin e propozimit të doktorantit për mentorin dhe temën.

7. Në rast se Këshilli i Fakultetit miraton projekt-propozimin e kandidatit dhe mentorin, i njëjti obligohet që të propozoj edhe komisionin vlerësues.
8. Për regjistrimin e semestrit të tretë, doktoranti duhet të ketë mbledhur të paktën 45 ECTS kredi, dhe për semestrin e katërt 90 ECTS kredi.

Publikimet shkencore dhe pjesëmarrja në konferenca shkencore ndërkombëtare janë aktivitete të detyrueshme që duhet të realizohen brenda tre semestrave të parë, përfshirë:

- a. **Publikimi si autor i parë ose autor korrespondent** i një punimi shkencor të bazuar në rezultatet e doktoratës në revista ndërkombëtare të indeksuara në SCOPUS ose WOS, si dhe një publikim në revista të tjera të indeksuara si EBSCO, DOAJ, WorldCat, EconPapers, etj. – 28 ECTS kredi, të cilat realizohen gjatë semestrit të dytë dhe të tretë.
- b. **Prezantimi në një konferencë shkencore ndërkombëtare** si autor i parë ose autor korrespondent – deri në 10 ECTS kredi, e cila realizohet gjatë semestrit të tretë.
- c. **Në tre semestrat e mbetur, doktoranti duhet të grumbullojë 90 ECTS kredi në total si vijon:**
- d. **Prezantimi i progresit në disertacionin e doktoratës** – 60 ECTS kredi.
- e. **Mbrojtja publike e disertacionit të doktoratës** – 30 ECTS kredi.
- f. **Miratimi nga Mentori:** Të gjitha publikimet dhe prezantimet e doktorantit duhet të kenë miratimin paraprak të mentorit si bashkëautor.

Mentorimi **Neni 9**

1. Të drejtë për të udhëhequr kandidatë për doktoratë ka:
 - 1.1. Mësimdhënësi që është në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ, nëse ka së paku tre vite përvojë hulumtuese pas mbrojtjes së doktoraturës dhe titull akademik të aprovuar, si dhe së paku tri (3) punime të botuara në revista me recension ndërkombëtar në 5 vitet e fundit.
 - 1.2. Mentori, në raste të veçanta, mund të jetë edhe profesor emeritus i cili i plotëson kushtet sipas pikës 1.1. të këtij neni.
2. Mentori, pa përjashtim, duhet të jetë nga fusha e ngushtë shkencore nga e cila përgatitet doktorata.
3. Secili kandidat mund të ketë komentor të jashtëm, me kushte të parapara në pikën 1.1. të këtij neni.
4. Komentori industrial është i preferueshëm të jetë pjesë e mentorimit së kandidatit.
 - 4.1. Komentori industrial duhet të ketë së paku 5 vite përvojë në sektorin me interes të kandidatit dhe kualifikim universitar.
5. Komentori i jashtëm dhe komentori industrial duhet ta dorëzojë paraprakisht CV-në në Këshillin e doktoratës së njësisë akademike.
6. Nje mentor nuk mund të udhëheqë më shumë se tre kandidatë në të njëjtën kohë.
7. Mësimdhënësi i një njësie akademike të Universitetit "Haxhi Zeka" mund të jetë mentor në ndonjë universitet tjetër nëse ka leje nga njësia akademike.
8. Mentori i cili është emëruar në këtë funksion para se të pensionohet ka të drejtë ta kryejë mentorimin deri në fund.
9. Në rast të programeve në fushën ndërdisiplinore/multidisiplinare është i obliguar

mentorimi i dyfishtë.

10. Vendimin për mentorin, komentorin dhe komentorin industrial e merr Senati, me propozim të Këshillit të doktoratës të njësisë akademike.

Obligimet e mentorit

Neni 10

1. Mentori e ka obligim që ta udhëheqë doktorantin gjatë punës së punimit të doktoratës, ta përcjellë cilësinë e punës së doktorantit, ta përkrahë publikimin e punimeve të tij, si dhe t'i mundësojë pjesëmarrjen në projekte shkencore dhe artistike, sipas mundësisë.
2. Në rast se janë më shumë se një mentor, secili prej tyre i mban përgjegjësitë e veta për pjesën e hulumtimit të përcaktuar paraprakisht dhe për procedurën e punës në punimin e doktoratës.
3. Mentori e ka obligim që një herë në vit të paraqesë raport për punën e doktorantit Këshillit për studimet e doktoratës të njësisë akademike, në formularë të Universitetit.
4. Mentori ka për obligim që njëherë në muaj të konsultohet me kandidatin.
5. Mentori ka për obligim që brenda periudhës prej një muaji të kthej përgjigje në pyetjet/kërkesat e kandidatit.
6. Në rast të vonësave të qëllimshme kandidati mund të parashtroj ankesë tek Këshilli i studimeve të doktoratës brenda njësisë akademike.

Obligimet dhe të drejtat e doktorantit

Neni 11

1. Pas emërimit të mentorit, doktoranti është i obliguar që një herë në vit t'ia paraqesë Këshillit të studimeve të doktoratës raportin për punën e tij (me mundësi të prezantimit të hulumtimit). Raporti dorëzohet në formularin e hartuar nga universiteti (Formulari 2).
2. Doktoranti ka të drejtë një herë gjatë studimeve ta ndërrojë mentorin ose temën, por jo pas aprovimit të projekt propozimit dhe temës në senat, në bazë të kërkesës me shkrim, si dhe të deklaratës së mentorit të deriatëhershëm. Përrjashtimisht, në rast të paaftësisë së mentorit për vazhdimin e mentorimit (të dëshmuar me vërtetim), apo në rast të vdekjes ose shkeljeve përkatëse ligjore, apo me ndonjë arsye që miratohet nga Këshilli i studimeve të doktoratës të njësisë akademike. Kërkesa dorëzohet në formularin e hartuar nga Universitetit (Formulari 3).
3. Doktoranti është i obliguar që para mbrojtjes së punimit të doktoratës ta ketë së paku një punim shkencor të botuar në revistë me recension ndërkombëtar të indeksuar në platformat SCOPUS apo WEB OF SCIENCE. Punimi shkencor duhet të jetë pjesë e rezultateve të hulumtimit të doktoratës (në të cilin është autor i parë ose autor korespondent) ose të ketë promovim publik të veprës artistike në hapësira publike. Një punim mund ta kualifikojë vetëm një doktorant.
4. Kandidati është i obliguar që një herë në vit të bëjë prezantimin e progresit të temës, në afatin e përcaktuar nga Këshilli i studimeve të doktoratës.
5. Doktoranti është i obliguar që t'i përmbush të gjitha kërkesat sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Punimi i doktoratës

Neni 12

Punimi i doktoratës është një punim shkencor i shkruar nga kandidati, i cili shtjellon në

mënyrë origjinale dhe unike një apo më shumë tema përkatëse shkencore dhe i cili i nënshtrohet vlerësimit publik shkencor ose artistik.

Përjashtim nga kjo procedurë janë punimet e veçanta të doktoratës, siq i parashikon neni 13 i kësaj rregulloreje.

Neni 13

Format e punimit të doktoratës janë:

1. **Monografia shkencore** nga e cila duhet të publikohet një punim shkencor në revista me recension ndërkombëtar të indeksuara në platformat SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE; ose
2. **Punimi i doktoratës** është koleksion i së paku 3 punimeve shkencore, nga të cilat doktoranti e publikon së paku një si autor i parë apo autor korespondent, në revista me recension ndërkombëtar të indeksuara në platformat SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE, ndërsa 2 të tjera duhet të jenë në nivel shkencor për publikim.
3. **Punimi i doktoratës** në lëmin artistik është hulumtim artistik origjinal në kontekst të krijimtarisë bashkëkohore artistike dhe mbaron me prezantimin e veprës artistike dhe me një punim teorik adekuat.

Neni 14

1. Punimi i doktoratës duhet të jetë i shkruar në gjuhën shqipe.
2. Në raste të veçanta, pas aprovimit të Këshillit të doktoratës, punimi i doktoratës mund të shkruhet edhe në ndonjë gjuhë tjetër, por detyrimisht të dorëzohet rezymja e punimit edhe në gjuhën shqipe.
3. Titulli, rezymja dhe fjalët kyçe të punimit të doktoratës, duhet të jenë të shkruara në gjuhën shqipe dhe angleze. Rezymja duhet të mundësojë të kuptuarit e qëllimit të punimit, të metodave të hulumtimit, të rezultateve dhe përfundimeve të përgjithshme.

Procedura e paraqitjes, e vlerësimit dhe e pranimit të temës të kërkimit të doktoratës

Neni 15

1. Gjatë vitit të parë të studimeve të doktoratës doktoranti e propozon mentorin dhe temën, apo dhe komentarin e jashtëm dhe komentarin industrial, si dhe para marrëveshjes e kushteve të punës, dhe eventualisht kushtet e financimit të kërkimit.
2. Doktoranti e fillon procedurën e paraqitjes së projekt-propozimit të temës së doktoratës me dorëzimin e fletëparaqitjes, e cila i përmban shënimet personale të doktorantit, jetëshkrimin dhe titullin e temës së propozuar, të dhënat për mentorin e propozuar, dhe komentarin e jashtëm dhe komentarin industrial (nëse ka), dhe kompetencat e tij/tyre, arsyeshmërinë e temës dhe pritjet e kontributit shkencor të kërkimit të propozuar, vlerësimin e shpenzimeve të kërkimit, si dhe deklaratën se nuk ka paraqitur punim doktrate me të njëjtën temë në studime të tjera universitare, përkatësisht në ndonjë universitet tjetër. Tema e punimit të doktoratës paraqitet në formularët për studimet e doktoratës të bashkangjitura në shtojcë të kësaj rregulloreje.
3. Këshilli i njësisë akademike, me propozim të Këshillit të studimeve të doktoratës, e emëron komisionin për vlerësimin dhe përshtatshmërinë e temës dhe propozimin e mentorit/komentorëve në afat prej një muaji nga data e protokollimit të kërkesës së parashtruar. Ky komision përbëhet prej tre ose pesë anëtarë, nga të cilët së paku një

anëtar nuk duhet të jetë mësimdhënës i studimeve në fjalë e as i punësuar në njësinë akademike (fakultetin), e cila është përgjegjëse e studimeve. Mentori dhe komentori i jashtëm i propozuar nuk mund të jenë anëtarë të Komisionit Vlerësues.

4. Komisioni për vlerësimin e temës e jep vlerësimin për kontributin shkencor/artistik origjinal dhe për zbatueshmërinë e kërkimit në pikëpamje financiare dhe organizative, si dhe e bën propozimin e mentorit/komentorëve më së largu një (1) muaj pas paraqitjes së kërkesës.
5. Këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike duhet ta shqyrtojë propozimin e komisionit për vlerësim të temës dhe propozimin e mentorit/komentorëve në semestrin e tretë të studimeve të doktoratës.
6. Projekt-propozimi i punimit të doktoratës mbrohet para Këshillit të studimeve të doktoratës të njësisë akademike, para komisionit për vlerësim dhe mentorit/komentorëve të propozuar, 15 ditë pas dorëzimit të raportit të komisionit për vlerësim.
7. Këshilli qëndror i studimeve të doktoratës me propozim të Këshillit të njësisë akademik, ia propozon temën dhe mentorin/komentorët për miratim Senatit të Universitetit. Pas marrjes së opinionit të Këshillit Qëndror të Studimeve të Doktoratës, Senati shqyrton temën dhe mentorin/komentorët më së largu dy muaj nga pranimi i kërkesës nga njësia akademike.
8. Vendimi i Senatit mund:
 - 8.1. të pranojë propozimin origjinal,
 - 8.2. të kërkojë nga kandidati që të zgjerojë apo ndryshojë temën
 - 8.3. të kërkojë nga Këshilli i njësisë akademike të propozojë tjetër mentor
9. Të gjitha hulumtimet shkencore në njerëz dhe me njerëz ose me shtazë doemos duhet të jenë në pajtim me dispozitat e Rregullores së Këshillit Etik, duhet ta kenë lejen e Këshillit etik të fakultetit apo Universitetit, si dhe të institucionit në të cilin zbatohet hulumtimi; pelqimin e të gjithë të hulumtuarve veç e veç (pacientëve, përkatesisht vullnetareve), nëse janë në gjendje të aftë ta bëjnë këtë, përkatesisht të kujdestarëve të tyre ose të përfaqësuesit ligjorë të tyre.

Procedura e vlerësimit të punimit të doktoratës

Neni 16

1. Punimin e doktoratës, me pelqimin dhe mendimin e mentorit dhe komentorit të jashtëm (nëse ka) të shkruar dhe të nënshkruar për hulumtimin e kryer dhe kontributin e arritur shkencor origjinal, doktoranti e dorëzon zyrtarisht në fakultet ose në Universitet (nëse studimet organizohen në nivel Universiteti).
2. Në rast se mentori nuk pajtohet ta japë pelqimin, e ka obligim që brenda 15 ditësh ta japë me shkrim arsyetimin. Pas kësaj periudhe, në afat prej 15 ditësh pas dorëzimit të arsyeshmërisë së mentorit, Këshilli për studime të doktoratës i njësisë akademike e shqyrton arsyeshmërinë e mentorit dhe i propozon Këshillit të njësisë akademike formimin ose refuzimin e emërimit të komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës. Në të dyja raste, arsyeshmëria e mentorit u jepet anëtarëve të komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës, të cilët do ta kenë parasysh gjatë vlerësimit.
3. Në rast se komentori i jashtëm nuk pajtohet me raportin sipas pikës 1 të këtij neni atëherë ka të drejt të shkruaj raport të veçantë të cilin e dërgon në Këshill për studimet

- e doktoratës të njësisë akademike.
4. Para se të dorëzohet punimi në procedurë për vlerësim, shërbimi i studimeve të doktoratës i njësisë akademike duhet ta vërtetojë me shkrim se doktoranti i ka kryer të gjitha obligimet ashtu siq është paraparë me programin e studimeve të doktoratës sipas kësaj rregulloreje.
 5. Për vlerësimin e punimit, doktoranti e paraqet punimin e shkruar në formë fizike dhe elektronike. Te veprat artistike të doktorantit, pos prezantimit publik, doktoranti e dorëzon edhe pjesën teorike, si dhe dokumentacionin përkatës për vlerësimin e punimit.
 6. Këshilli i njësisë akademike, me propozim të Këshillit të studimeve të doktoratës, e emëron komisionin për vlerësimin e punimit të doktoratës. Komisioni i ka tre ose pesë anëtarë. Inkurajohet përfshirja e së paku një anëtari nga ndonjë Universitet tjetër vendor ose ndërkombëtar. Mentori dhe komentori i jashtëm nuk mund të jetë anëtar i komisionit për vlerësimin e punimit.
 7. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës duhet të kenë së paku thirrjen akademik profesor asistent (prof. ass.), ku së paku njëri duhet të ketë thirrje profesor i asocuar në fushën përkatëse (prof. asoc.).
 8. Njëherazi me emërimin e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës, Universiteti e shpall titullin dhe rezyrenë e punimit në gjuhën shqipe dhe angleze në ueb faqen e Universitetit, dhe në këtë mënyrë mundëson që punimi t'i nënshtrohet kritikës shkencore dhe profesionale.
 9. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës dhe të gjithë ata të cilëve u është mundësuar shqyrtimi i punimit të doktoratës janë të obliguar që para se të paraqitet pubiikisht vlerësimi të kenë kujdes me të dhënat dhe të arriturat në punimin në fjalë, me qëllim të ruajtjes se kontributit shkencor të punimit të doktoratës si pronë intelektuale.
 10. Komisioni vlerësues i tezës së Doktoratës, është i obliguar të vlerësoj dhe raportoj për çdo shkelje etike, plagjiaturë, fabrikim të të dhënave, etj.
 11. Komisioni vlerësues duhet shmangur çfarëdo lloj paragjykimi në hulumtim, ose në çdo proces ku kandidatët që kryejnë studimin ndikojnë në rezultatet për të marrë një përfundim të dhënë;
 12. Shkeljet e standardeve të ndershmërisë akademike, pa marrë parasysh sa të vogla, janë të papranueshme dhe kanë pasoja të rënda, duke u ndëshkuar deri në pezullimin ose largimin nga Universiteti.
 13. Komisioni për vlerësimin e punimit të doktoratës është i obliguar që brenda 45 ditësh nga emërimi ta përpilojë raportin e shkruar për vlerësimin e punimit të doktoratës dhe ta dorëzoj te Këshilli i njësisë akademike. Kryetari i komisionit e përgatit raportin duke i pasur parasysh mendimet me shkrim të anëtarëve të komisionit, ndërkaq raportin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e komisionit. Anëtarët e komisionit kanë të drejtë të japin vlerësim të veçuar.
- Komisioni për vlerësimin e punimit të doktoratës propozon:
- 13.1. pranimin e punimit të doktoratës me deklaratë eksplicite për kontributin origjinal shkencor ose kontributin artistik, ose
 - 13.2. plotësimin e punimit të doktoratës dhe vlerësimin përfundimtar, ose
 - 13.3. refuzimin e punimit të doktoratës, pas së cilës doktoranti e humb të drejtën e arritjes së gradës doktor shkence ose artistike me atë studim.

Neni 17

1. Me rastin e dorëzimit të disertacionit Këshilli i njësisë akademike duhet të organizojë mbrojtjen e bardhë të disertacionit brenda 20 ditëve kalendarik para komisionit vlerësues.
2. Në rast se disertacioni kthehet në plotësim apo ndryshim nga komisioni vlerësues gjatë mbrojtjes së bardhë, Këshilli i njësisë akademike cakton periudhën e përshtatshme që duhet të jetë periudhë prej së paku dy (2) muaj dhe më së shumti gjashtë (6) muaj.
3. Disertacioni i plotësuar apo i ndryshuar duhet t'i dorëzohet Këshillit të njësisë akademike bashkë me mendimin e mentorit apo komentorëve.
4. Me rastin e miratimit të raportit të komisionit për vlerësim, Këshilli i njësisë akademike formon komisionin për mbrojtje të doktoratës. Komisioni për mbrojtje të punimit të doktoratës përbëhet nga tre (3) anëtarë. Komisioni për mbrojtje të punimit të doktoratës duhet të jetë në përbërje të njëjtë si komisioni për vlerësimin e punimit të doktoratës, përpos në raste të veçanta.
5. Vendimi i Këshillit të njësisë akademike për aprovimin e disertacionit duhet të ratifikohet nga Senati.

Neni 18

1. Doktoranti duhet t'ia dorëzojë Këshillit të njësisë akademike punimin e kompletuar të doktoratës për vlerësim brenda 3 viteve nga dita kur është pranuar tema nga Senati i UHZ-së.
2. Dorëzimi i punimit të kompletuar të doktoratës bëhet së bashku me kërkesën për vlerësim të punimit.
3. Doktoranti mund të kërkojë nga Këshilli i njësisë akademike që t'i vazhdohet periudha e disertacionit ose e kërkimeve edhe për një vit.
4. Në rast se doktoranti nuk e dorëzon punimin e kompletuar të doktoratës për vlerësim brenda periudhës së rregullt ose të vazhduar të disertacionit, konsiderohet se doktoranti heq dorë nga tema e caktuar e disertacionit.

Procedura e mbrojtjes së punimit të doktoratës

Neni 19

1. Doktoranti, në marrëveshje me dekanin e njësisë akademike dhe me komisionin për mbrojtje të punimit të doktoratës, detyrimisht duhet ta bëjë mbrojtjen publike të punimit të doktoratës brenda afatit prej dy (2) muajve nga dita e ratifikimit në senat.
2. Mentori merr pjesë në mbrojtje të punimit të doktoratës në anën e doktorantit, mirëpo nuk ka të drejtë në vendimmarrje.
3. Mbrojtja e punimit të doktoratës bëhet me prezencë fizike dhe është publike. Thirrja për mbrojtje publike duhet të shpallet në hapësirat e njësisë akademike, në faqen zyrtare të universitetit, së paku 8 (tetë) ditë para mbrojtjes.
4. Mbrojtja duhet të organizohet në hapësirën e universitetit, gjegjësisht të njësive të tij, në gjuhën në të cilën është shkruar punimi i doktoratës. Në rast të doktoratave të dyfishta dhe të doktoratave të realizuara në kuadër të studimeve të përbashkëta, mbrojtja mund të organizohet në universitet tjetër. Procedura e mbrojtjes zhvillohet bazuar në protokollin e prezantuar në formularin F4.

5. Komisioni për mbrojtje të punimit të doktoratës e bën vlerësimin menjëherë pas mbrojtjes publike të punimit të doktoratës. Vlerësimi i mbrojtjes së punimit të doktoratës mund të jetë:
 - a. Kaloj;
 - b. Nuk kaloj;
6. Në rastet kur komisioni për mbrojtje vlerëson që doktoranti ka dështuar të mbrojë doktoratën për shkak të mosrespektimit të qëllimshëm të procedurave të mbrojtjes, injorimit me dashje të komisionit për mbrojtje ose të ndonjë sjelljeje tjetër në kundërshtim me normat e zakonshme të mbrojtjes, doktoranti humb të drejtën për mbrojtje të punimit të doktoratës.
7. Në raste kur komisioni për mbrojtje vlerëson që doktoranti ka dështuar të mbrojë doktoratën për shkak të përgatitjes së pamjaftueshme të procesit të mbrojtjes, dështimit në dhënien e përgjigjeve meritore në pyetjet e komisionit ose krijimit të përshtypjes së bazuar për mosnjohje serioze të materies së prezantuar në punim, komisioni mund të marrë vendim që doktorantit t'i ofrohet një periudhë prej 1 viti për përsëritje të procesit të mbrojtjes. Nëse edhe pas tentimit të dytë, doktoranti dështon të mbrojë me sukses punimin e tij, ai/ajo e humb të drejtën për mbrojtje të punimit të doktoratës.
8. Vendimi, bazuar në vlerësimin që rezulton nga procesi i mbrojtjes, merret me shumicë votash të anëtarëve të komisionit për mbrojtje të punimit të doktoratës, të konstatuara me nënshkrimin e tyre.
9. Për procedurën e mbrojtjes përpilohet procesverbali në gjuhën shqipe, e në rast se mbrojtja bëhet në gjuhë tjetër, procesverbali përpilohet edhe në atë gjuhë.

Revokimi i titullit "Doktor i shkencave"

Neni 20

1. Titulli akademik Doktor shkence mund të revokohet në rast të dëshmisë se:
 - 1.1. disertacioni nuk ka qenë punim i vetë kandidatit;
 - 1.2. disertacioni nuk ka qenë si rezultat i arritjes personale të kandidatit;
 - 1.3. disertacioni është i bazuar në pjesët relevante të rezultateve të mëparshme të botuara shkencore nga individët apo nga institucionet tjera;
 - 1.4. është plagjiat apo shkelje e të drejtës së autorit;
 - 1.5. është praktikë tjetër joetike.
2. Ankesa për revokim mund t'i parashtrohet Këshillit të njësisë akademike nga ana e çdo individi apo institucioni, e mbështetur me të dhëna të hollësishme me shkrim.
3. Pas ankesës, Këshilli i njësisë akademike formon një komision tre (3) anëtarësh nga profesorët e disiplinës së njëjtë shkencore me disertacionin.
4. Anëtarët e komisioneve të disertacionit të ankimuar nuk do të zgjedhen në këtë komision.
5. Komisioni paraqet një raport të vlerësimit në lidhje me arsyeshmërinë e ankesës dhe propozon procedura të mëtutjeshme brenda dy (2) muajve pasi të ketë filluar procedura.
6. Pas raportit dhe propozimit të komisionit, Këshilli i njësisë akademike vendos të refuzojë apo të pranojë ankesën për revokim në mbledhjen e ardhshme.
7. Në rast se Këshilli i njësisë akademike e pranon ankesën, Senati do të votojë për këtë vendim në mbledhjen e ardhshme. Doktor i shkencës në fjalë duhet të ftohet që të dëshmojë para Senatit.

Neni 21

1. Në rast se rezultatet e hulumtimit të punimit të doktoratës paraqesin inovacion, i cili ka nevojë të mbrohet me të drejtat e pronës intelektuale, doktoranti dhe mentori për këtë e informojnë Komisionin Qendror të Studimeve të Doktoratës. Në këtë rast, doktoranti, me pëlqim të mentorit, para se ta dorëzojë punimin e doktoratës për vlerësim, mund të bëjë kërkesë që me doktoratën e dorëzuar të veprohet në mënyrë diskrete, deri në momentin e mbrojtjes publike.
2. Komisioni Qendror i Studimeve të Doktoratës e zbaton procedurën për mbrojtje juridike dhe komerciale të rezultateve të hulumtimit, në pajtueshmëri me rregulloren për pronësi intelektuale. Në këtë rast, mbrojtja publike mund të shtyhet, në pajtim me doktorantin, më së largu për një vit, nga dita e ratifikimit të punimit në senat. Vendimi për shtyrje të mbrojtjes publike merret nga senati, bazuar në rekomandimin e KQSD-së dhe kërkesën e doktorantit.
3. Në rast se inovacioni patentohet dhe komercializohet, universiteti e fiton të drejtën e pjesëmarrjes 8% të të ardhurave përjetësisht.

Publikimi dhe ruajtja e punimit të doktoratës

Neni 22

1. Punimi i doktoratës në tërësi publikohet në ueb faqen e universitetit, më së largu një muaj pas mbrojtjes. Informacioni për pjesën praktike të punimit të doktoratës nga lëmi artistik shpallet në ueb faqe të universitetit më së largu një muaj pas mbrojtjes. Në raste të jashtëzakonshme, bazuar në arsyetimin e argumentuar mirë të të doktoruarit dhe me rekomandim të Komisionit Qendror të Studimeve të Doktoratës, senati mund të vendosë që publikimi në faqe të internetit të shtyhet deri në dy vite.
2. Punimi i doktoratës në formë të shtypur ruhet në tri (3) kopje në arkivin e njësisë akademike, tri (3) kopje në arkivin e universitetit dhe tri (3) kopje në Bibliotekën Qendrore Universitare.
3. Punimi i doktoratës nga lëmi artistik ruhet, në përputhje me llojin e veprës, në formë adekuate (në formë të shkruar, në formë fotografie, videoregjistrimi, audioregjistrimi) në arkivin e njësisë akademike, në arkivin e universitetit, në Bibliotekën Qendrore Universitare, më së largu një muaj pas mbrojtjes.

Promovimi

Neni 23

1. Pas përfundimit të suksesshëm të mbrojtjes së disertacionit, i doktoruari fiton titullin doktor i shkencave (dr. sc.) apo ekuivalente, ndërsa të drejtat e plota të gradës shkencore dhe të diplomës, me rastin e promovimit, kur edhe e bën betimin dhe nënshkruhet në Librin e doktoratës shkencore/artistike të universitetit.
2. Doktoranti duhet që, brenda një muaji pas mbrojtjes, ta plotësojë formularin për promovim në gradë doktor shkence/arti dhe ta dorëzojë në shërbimin e studimeve të doktoratës të njësisë akademike punimin e doktoratës, të lidhur dhe në versionin elektronik për publikim në faqen e internetit të universitetit, gjegjësisht në formë të dokumentacionit të përshtatshëm të punimit të doktoratës në lëmin artistik (forma e shkruar, fotografi, videoregjistrim, audioregjistrim etj.).

3. Rektori ia dorëzon doktorantit diplomën e doktoratës në promovimin solemn, në të cilin doktoranti duhet të marrë pjesë personalisht ose, në rast të pamundësisë së pjesëmarrjes, ta autorizojë me shkrim një person tjetër që ta marrë diplomën për të.

Mënyra e sigurimit të cilësisë së studimeve të doktoratës

Neni 24

1. Shërbimi i studimeve të doktoratës i njësisë akademike është i obliguar që të kujdeset për mbajtje dhe ruajtje të shënimeve të hollësishme lidhur me punimin hulumtues dhe për kryerjen e detyrave të tjera studimore të çdo doktoranti, duke nënkuptuar këtu planin e obligimeve (përgatitja e dosjes së doktorantit), mbajtjen e shënimeve për numrin e doktorantëve të regjistruar dhe numrin e doktorantëve të cilët e kanë mbrojtur punimin e doktoratës.
2. Bazuar në raportet vjetore të doktorantëve (formulari 5) dhe të mentorëve (formulari 6), Këshilli i studimeve të doktoratës, për çdo vit, e përgatit raportin e vetëvlerësimit lidhur me programin e studimeve të doktoratës (formulari 7) dhe njoftimin përkatës e përcjell në Këshillin e fakultetit, ndërsa ky i fundit në Këshillin qendror të studimeve të doktoratës dhe senatin e universitetit.
3. Raporti vjetor mbi vetëvlerësimin i bashkëngjitet kërkesës për riakreditim.
4. Kriteret për vlerësim përfshijnë: produktin shkencor/artistik të mësimdhënësve dhe të doktorantëve, mësimdhënien, cilësinë e punimeve të doktoratës, treguesit statistikorë të kohëzgjatjes së studimeve, treguesit statistikorë të numrit vjetor të doktorëve të rinj në krahasim me numrin e doktorantëve, si dhe realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 25

1. Formularët janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje në tërësi zbatohen për studimet e doktoratës të cilat fillojnë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.
3. Për të gjitha çështjet tjera të cilat nuk janë rregulluar me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, si dhe aktet e tjera normative.
4. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregulloreje mund të bëhet sipas procedurës së njëjtë të nxjerrjes.
5. Me hyrje në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja me nr. prot. 369/20 të datës 18.02.2020, për studimet e doktoratës.

Neni 26

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati i UHZ-së.

Kryesuesi i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi



